



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2023:066228

Datë: 06.12.2024

Numri i dokumentit: 06325628

P.nr.132/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA VITI, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, përmes gjyqtares Blerina Jakupi Ramadani, me bashkëpunëtorin profesional Fitim Limani, duke vendosur në çështjen penale të pandehurit A.S., nga fshati S., Komuna e Vitisë, për shkak të veprës penale kanosja nga neni 181 paragrafi 1 të KPRK-së, me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, për dhënien e urdhërit ndëshkimor me numër PP.II.nr.451/2023, të datës 09.03.2023, pas konstatimit të dhënave në aktakuzë, të cilat ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhërit ndëshkimor, me datë 06.12.2024, mori këtë:

AKTGJYKIM

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.451/2023, e datës 09.03.2023 dhe kjo gjykatë, jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri A.S. nga babai L., nëna S., i lindur me datë 14.03.1988, me vendbanim në fshatin S., Komuna e Vitisë, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal 1171460391, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 11.02.2023, rreth orës 12:35 minuta, në kafiterinë “Leo” në QT “Interex” në Viti, i pandehuri A.S., pas një mosmarrëveshje me të dëmtuarin A.A., të njëjtin e kanos seriozisht, ashtu që kur i pandehuri shkon në kafiterinë e tij dhe kamerieri nuk e shërben, i njëjti revoltohet e përplas tavolinën qohet në këmbë dhe e kanos të dëmtuarin me fjalët “ka me të vra ty dhe gjithë familjen”, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e veta tek i dëmtuari ka shkaktuar frikë dhe shqetësim të madh emocional.

-me çka ka kryer veprën penale kanosja nga neni 181 paragrafi 1 i KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 38, 43 të KPRK-së dhe nenit 450, 458, 495 par. 1, 2 dhe 3 të KPPRK-së, të pandehurit të lartcekur:

I SHQIPTON **Dënim me gjobë**

Ashtu që për veprën penale sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi, i caktohet dënim me gjobë në shumën prej 200.00 € (dyqind), të cilin dënim i pandehuri obligohet t'a paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron, ose nuk mund t'a paguajë gjobën, atëherë gjykata do t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim, ashtu që 1 (një) ditë burgim do të barazohet me 20€ (njëzet) të dënimit me gjobë.

I dëmtuari A.A., me vendbanim në Viti, rruga "UÇK", për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet i pandehuri që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet) € dhe 20 (njëzet) € për viktimat e krimit konform nenit 39 paragrafi 3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave, në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 15.03.2023, në Gjykatën Themelore Gjilan, Dega e gjykatës në Viti, ka paraqitur aktakuzën me numër PP.II.nr.451/2023, të datës 09.03.2023, ndaj të pandehurit A.S., nga fshati S., Komuna e Vitisë, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 181 paragrafi 1 të KPRK-së, si dhe kërkesën P.II.nr.451/2023, e datës 09.03.2023, për dhënien e urdhërit ndëshkimor me shqiptimin e dënimit me gjobë, me arsyetimin se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPPRK-së.

Prokurori i shtetit me parashtrësat e datës 28.03.2024 dhe datë 10.10.2024 ka bërë përmirësimin e aktakuzës sa i përker kohës dhe vendit të kryerjes së veprës penale, ashtu që si datë e kryerjes së veprës penale duhet të jetë data 11.02.2023, ndërsa vendi i kryerjes së veprës penale duhet të jetë, kafiteria "Leo", në Qendrën Tregtare "Interex" në Viti.

Gjykata pas leximit dhe analizimit të aktakuzës përkatëse dhe shkresave të lëndës së bashku me kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor, gjeti se në këtë çështje penalo juridike janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPPRK-së për dhënien e urdhërit ndëshkimor dhe bazuar në nenin 495 par. 1, 2 dhe 3 të KPPRK-së, vendosi që të pranojë kërkesën e lartë cekur ashtu që të pandehurit t'i shqiptojë dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë si dhe provat e bashkëngjitura në të, ofrojnë bazë të mjaftueshme për një gjë të tillë dhe deri tek një konstatim i tillë gjykata erdhi duke u bazuar edhe në shkresat e lëndës siç janë: kallëzimi penal me numër 2023-ÇG-047, i datës 03.03.2023, raporti fillestar i incidentit I datës 13.02.2023, raporti i oficerit, Kartela e viktimës, deklarata e dëshmitarit A.A., deklarata e dëshmitares A.H., deklarata e të pandehurit A.S., foto nga vendi i ngjarjes, një DVD, si dhe dokumentacioni tjetër përcjellës, gjeti se këto janë prova të besueshme dhe të mjaftueshme mbi bazën e të cilave konstatohet bindshëm se i pandehuri ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë me aktin akuzues.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se edhe me shqiptimin e dënimit me gjobë, ashtu siç është propozuar në kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor mund të arrihen qëllimet e dënimit të parapara në nenin 38 të KPRK-së.

Bazuar në nenin 462 par. 1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, i dëmtuari udhëzohet që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest civil.

Vendimin sa i përket shpenzimeve procedurale, gjykata e mori duke u mbështetur në nenin 450 paragrafi 1 të KPP-së.

Nga të lartë cekurat dhe mbështetur në nenin 495 paragrafi 1, 2 dhe 3, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA VITI
Departamenti i përgjithshëm
P.nr.132/2023, me datë 06.12.2024

Gjyqtarja,
Blerina Jakupi Ramadani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes së të njëjtit, gjyqtare individuale të kësaj gjykate. Kundërshtimi nuk duhet domosdo të arsyetohet. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhërin ndëshkimor merr formën e prerë dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.